



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 227 Akti

Nr. 285 Vendimi

Tiranë, më 3.8.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	kryesuese
Valbona Sanxhaktari	anëtare
Genta Tafa (Bungo)	relatore

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, në datën 23.7.2020, në selinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. Nezir Gjoka, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: **Neni G, i Aneksit të Kushtetutës** së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Germa “a”, e pikës 1 të nenit 64 dhe neni 65, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), mori në shqyrtim dhe analizoi njoftimin e dërguar nga Këshilli i Lartë i

Prokurorisë, me nr. *** prot., datë 24.6.2020 për vendimin nr. ***, datë 12.6.2020, si dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Nezir Gjoka ka ushtruar funksionin prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Në bazë të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Nezir Gjoka, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.11.2018 me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët: Suela Zhegu, Alma Faskaj dhe Genta Tafa (Bungo).

3. Menjëherë, pas hedhjes së shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 – 33 të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 – 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sipas neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin nr. 1, datë 21.11.2018, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme, për procedurën e rivlerësimit.

5. Komisioni, me anë të postës elektronike, njoftoi subjektin e rivlerësimit se kishte filluar procesin e rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr. 84/2016, “ Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

6. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit u njoftua me përbërjen e trupit gjykues, të shortuar në datën 15.11.2018 dhe iu kërkua të deklaronte nëse ishte në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

7. Në përgjigje të *e-mail*-it, të dërguar sipas pikës 6 më lart, subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

8. Me vendimin nr. ***, datë 9.3.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit u vendos zëvendësimi i anëtarit të trupit gjykues, znj. Alma Faskaj, për shkak të largimit të saj për një kohë të pacaktuar, për arsye shëndetësore. Me shortin e hedhur më 9.3.2020, u caktuar komisioner zëvendësues znj. Valbona Sanxhaktari. Më 9.3.2020 subjekti i rivlerësimit u njoftua elektronikisht për zëvendësimin e anëtares së trupit gjykues, për të cilën deklaroi se nuk ishte në kushtet e konfliktit të interesit.

9. Pasi relatori i çështjes kreu një hetim të plotë dhe të gjithanshëm sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, paraqiti para trupit gjykues dhe vëzhguesit ndërkombëtar, rezultatet e hetimit dhe i rekomandoi trupit gjykues dhe vëzhguesit ndërkombëtar mbylljen e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z.Nezir Gjoka, vetëm për kriterin e pasurisë.

10. Në mbledhjen e datës 12.3.2020, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi arriti në përfundimin se provat në lidhje me kriterin e pasurisë kanë nivelin e

provueshmërisë, me vendimin nr. 2, vendosi të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Nezir Gjoka, dhe të njoftojë subjektin se ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, sipas përcaktimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

11. Me anë të postës elektronike¹ subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi mbylljen e hetimit kryesisht dhe kalimin e barrës së provës vetëm për kriterin e pasurisë, për sa rezultonte nga hetimi kryesisht. Në po të njëjtin *e-mail*, subjektit të rivlerësimit iu bënë me dije të drejtat që gëzon sipas ligjit për: (i) njohjen me dokumentet e dosjes dhe marrjen kopje të tyre menjëherë pas marrjes së njoftimit; (ii) të drejtën për të thirrur dëshmitar apo marrjen e çdo prove mbështetëse; (iii) të drejtën për të paraqitur shpjegime apo prova me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit, brenda 15 ditëve nga e nesërmyja e ditës së shfuqizimit të kufizimeve të vendosura me Aktin Normativ nr. 9, datë 25.3.2020. Bashkëlidhur këtij *e-mail*-i, subjektit të rivlerësimit iu dërguan: (i) rezultatet e hetimit kryesisht në versionin *word* dhe *pdf*; (ii) analiza financiare në *pdf* dhe *excel*; (iii) dhe metodika e përdorur në analizën financiare.

12. Subjekti nuk është paraqitur pranë Komisionit për t’u njohur me dokumentet e dosjes gjyqësore dhe marrjen e kopjeve të tyre.

13. Në datë 2.6.2020 subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë KLP-së, duke vënë në dijeni dhe Komisionin, kërkesën për dorëheqje të parevokueshme për arsye shëndetësore.

14. Në datë 24.6.2020, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me shkresën nr. *** prot., njoftoi Komisionin se në seancën plenare të datës 12.6.2020 ka vendosur të miratojë kërkesën për dorëheqje të z. Nezir Gjoka, duke deklaruar mbarimin e statusit të subjektit të rivlerësimit si magjistrat, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Bashkëlidhur kësaj shkrese KLP-ja ka dërguar kopjen e vendimit nr. ***, datë 12.6.2020.

15. Me vendimin nr. ***, datë 12.6.2020, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vendosur: (i) deklarimin e mbarimit të statusit, për shkak dorëheqjeje, të magjistratit Nezir Gjoka, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë; (ii) dorëheqja i jep efektet në datën 30.6.2020; (iii) të njoftohet për këtë vendim z. Nezir Gjoka, Prokuroria e Përgjithshme dhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit; (iv) Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

16. KLP-ja me shkresën nr. *** prot., datë 22.07.2020, informon Komisionin se vendimi nr. ***, datë 12.6.2020 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk është ankimuar, as pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe, as pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe vendimi ka marrë formë të prerë.

17. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegime të plota në lidhje me vullnetin e shprehur me aktin e dorëheqjes nga statusi i magjistratit, referuar nenit 65 të ligjit nr. 96/2016, si dhe duke marrë në konsideratë që KLP-ja, me vendim të formës së prerë, ka vendosur deklarimin e mbarimit të statusit për shkak të dorëheqjes të subjektit të rivlerësimit z. Nezir Gjoka, Komisioni vlerëson se nuk është e nevojshme të ftohet subjekti në seancë dëgjimore publike.

II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

18. Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Nezir Gjoka, ka filluar në respektim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës

¹ *E-mail*, datë 5.5.2020, ora 1:10 p.m., “Komisioni – Njoftim mbi mbylljen e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit”.

4 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

19. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara për sa më lart, konstaton se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;
- ii. Procesi i rivlerësimit ndaj tij nuk ka përfunduar me vendim sipas pikës 1 të nenit 58, dhe me një nga masat disiplinore respektive sipas nenit 59 “*Konfirmimi në detyrë*”, të nenit 60, “*Pezullimi nga detyra dhe detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit*”, dhe të nenit 61, “*Shkarkimi nga detyra*”;
- iii. Subjekti i rivlerësimit, z. Nezir Gjoka, ka ushtruar të drejtën për të dhënë dorëheqjen.
- iv. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dorëheqjen pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe ky i fundit me vendimin nr. ***, datë 12.6.2020 ka vendosur deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit Nezir Gjoka, për shkak të dorëheqjes.

20. Neni 65 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin të statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si vijon:

“1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës.

2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.”

21. Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: “1. *Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.* 2. *Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.*”

22. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, si vijon: “[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës [...]”.

23. Me paraqitjen e kërkesës nga subjekti i rivlerësimit dhe me shkresën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Komisioni është vënë në dijeni të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, z. Nezir Gjoka nga funksionet e magjistratit dhe të vendimit të KLP-së për mbarimin e këtij statusi në datën 12.6.2020.

24. KLP-ja me shkresën nr. ***, datë 22.7.2020, konfirmon se subjekti i rivlerësimit, z. Nezir Gjoka, nuk ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. ***, datë 12.6.2020, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”.

25. Në këto kushte, referuar fakteve të konstatuara më lart, Komisioni çmon se procesi i rivlerësimit për subjektin, z. Nezir Gjoka, duhet të ndërpritet sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

26. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit z. Nezir Gjoka humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë e Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshme, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe vendimin nr. 78, datë 12.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Nezir Gjoka, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Ndalimin e emërimit të z. Nezir Gjoka si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshme, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë në datën 3.8.2020

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Genta TAFA (BUNGO)
Relatore

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Fiorela Mandro